



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KONISPOL

KËSHILLI

Nr. 5 Prot

Konispol me 23.01.2026

**Lënda :** Njoftim për mbledhjen e Këshillit të Bashkisë date 28.01.2026.

**ANËTARËVE TË KËSHILLIT BASHKIAK KONISPOL**

**Për dijeni : KRYETARIT TË BASHKISË KONISPOL**

Ju njoftoj se ditën e , mërkurë , datë 28.01.2026 , ora 11: 00 do të zhvillohet mbledhja e radhës e Këshillit të Bashkisë Konispol e thirrur nga Kryetari i Këshillit në baze të ligjit nr.139/2015, neni 53 , pika 4:

**RENDI I DITËS :**

1-Miratimi i rendit të ditës.

2-Njohja me shprehjen e ligjshmerisë së vendimeve te miratuara në mbledhjen e datës 29.12.2025 nga institucioni i Prefektit të Qarkut Vlorë.

3-Miratimi i projekt-vendimit ; “Për miratimin e dhenies së pagesës personave P.A.K për periudhën 1-31 janar 2026 ”.

**Znj.Danijela Zejneli**

4- Miratimi i projekt-vendimit ; “Për miratimin për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi 6 % për periudhen 1-31 dhjetor 2025”

**Znj.Danijela Zejneli**

5- Miratimi i projekt-vendimit ; “Për miratimin e prioritetetve të Bashkisë Konispol për vitin 2026”

**Z.Ergest Dule    Z.Artur Beqiri**

6- Miratimi i projekt-vendimit ; “Për përdorimin e grandit të emergjencës”

**Z.Ergest Dule**

7- Miratimi i projekt-vendimit ; “Për miratimin e numrit maksimal të punonjësve të Bashkisë Konispol për vitin 2026”

**Z.Ergest Dule    Z..Emiljano Hazbiu**

8- Raportim : "Mbi punën vjetore të Këshillit Bashkiak Konispol për vitin 2025"

**Znj. Ilirjana Iljazi**

9 – Kërkesë .

**KRYËTARI I KËSHILLIT  
ARIANIT TAKA  
Në mungesë dhe me porosi**

**SEKRETARI**



## II- TRANSPARENCA

Sekretariati i Këshillit ka zbatuar me korrektësi kërkesat ligjore për njoftimet publike, duke i publikuar ato në faqen zyrtare të Bashkisë, në media lokale, si dhe duke njoftuar drejtoritë përkatëse të Bashkisë, në përputhje me ligjin nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", të ndryshuar, dhe Rregulloren e Funkcionimit të Këshillit të Bashkisë Konispol.

Në zbatim të rregullores së miratuar me VKB, është vënë në funksionim regjistri elektronik dhe fizik i ankesave, kërkesave, iniciativave dhe peticioneve. Ky regjistër shërben për të evidentuar dhe trajtuar në mënyrë transparente të gjitha ankesat dhe kërkesat që mbërrijnë në adresë të Këshillit.

Gjatë vitit janë dorëzuar në Sekretariat 3- kërkesa. Në bashkëpunim me Kryetarin e Këshillit, të gjitha janë adresuar dhe janë marrë përgjigjet brenda afateve ligjore. Forma e komunikimit ka qenë përmes postës zyrtare.

Për t'u përshtatur risive teknologjike dhe për të lehtësuar komunikimin me qytetarët, Këshilli Bashkiak ka krijuar një faqe në rrjetin social Facebook, ku publikon njoftime për mbledhjet dhe pranon ankesa, kërkesa, sugjerime dhe vërejtje nga qytetarët. Gjithashtu, të gjitha mbledhjet e Këshillit janë transmetuar drejtpërdrejt nga mediat lokale, duke i dhënë mundësi komunitetit të ndjekë diskutimet në kohë reale dhe të kontribuojë me mendime për çështjet në shqyrtim.

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", të ndryshuar, dhe ligjit nr. 146/2014 "Për Konsultimin Publik", gjatë periudhës 12-mujore të këtij viti, Këshilli Bashkiak, në bashkëpunim me Bashkinë Konispol, ka organizuar edhe dëgjesa publike. Këto dëgjesa u zhvilluan për të diskutuar projektvendimet mbi sistemin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2026, si dhe për projektbuxhetin e vitit 2026 të Bashkisë Konispol.

Në këto dëgjesa publike kanë marrë pjesë qytetarë të ndryshëm. Numri i pjesëmarrësve ka qenë i konsiderueshëm, duke siguruar një proces transparent dhe gjithëpërfshirës për adresimin e nevojave dhe shqetësimeve të komunitetit.

Është përditësuar faqa online e Këshillit Bashkiak me informacione për publikun nëpërmjet seksioneve të mëposhtme :

*Projektvendimet*

*Regjistri i transparences se mbledhjeve të KB*

## III- AKTIVITETET

Këshilli Bashkiak Konispol përgjatë vitit 2025 ka qenë pjesëmarrës në disa aktivitete të rëndësishme, dhe paraqiten si më poshtë

- a. Gjatë vitit 2025, me mbështetjen e Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor, Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV), Shoqatës për Autonomi Vendore (SHAV), dhe institucioneve partnere si ASPA dhe SHKQSH, u organizuan trajnime për këshilltarët vendorë dhe komisionet e përhershme të këshillave bashkiakë. Këto trajnime, të mbështetura nga Projekti "Bashki të Forta" (BtF2) dhe financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), synuan:
  - Fuqizimin e rolit të këshillave bashkiakë në shqyrtimin, vlerësimin dhe miratimin e projekt-akteve përmes punës së komisioneve të përhershme.
  - Rritjen e kapaciteteve menaxhuese të drejtuesve të këshillave për të siguruar përmbushjen e përgjegjësiave ligjore.

data 13.01.2026  
Ti 2 P, et  
[Signature]

**Drejtuar:**  
Bashkisë Konispol  
Z. Ergest Dule  
Kryetar i Bashkisë Konispol  
dhe Këshillit Bashkiak Konispol

**Lënda:** Kërkesë për ndërtimin e rrugës lidhëse për zonën e banimit

I nderuar Z. Kryetar,  
Të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak,

Ne, banorët dhe pronarët e banesave në zonën që shtrihet nga kryqëzimi mbi shtëpinë e Sheqir Korça deri te shtëpitë e familjeve Pajtim Çausi, Krenar Çausi dhe Ermal Çausi, ju drejtohem me këtë kërkesë për përfshirjen në planin e investimeve të Bashkisë Konispol të ndërtimit dhe sistemimit të rrugës së kësaj zone.

Aktualisht, ne kemi vendosur të ndërmarrim investime private për rehabilitimin e banesave tona, me qëllim kthimin e tyre në gjendje funksionale shërbimi. Në vijim, synimi ynë është të aplikojmë për ndërtimin e bujtinës turistike "Syri i Konispolit", duke bashkuar disa nga këto banesa dhe duke i kthyer ato në një atraksion turistik për zonën, përmes aplikimit edhe pranë AZHBR-së.

Për realizimin e këtij projekti, infrastruktura rrugore është kushti minimal dhe i domosdoshëm. Theksojmë se shërbimet bazë si energjia elektrike dhe furnizimi me ujë janë të pranishme, ndërsa mungesa e një rruge funksionale pengon seriozisht zhvillimin e mëtejshëm të zonës dhe investimet që kemi planifikuar.

Sa i përket karakteristikave teknike të rrugës së propozuar, ju bëjmë me dije se:

- Gjatësia totale e rrugës është **L = 126 m**
- Gjerësia e karrexhatës është **B = 3.0 m**
- Rruga parashikohet me **dy bankina anësore nga 0.5 m secila**, duke arritur një gjerësi totale prej **4.0 m**
- Janë parashikuar **dy tipe seksionesh gjatësore**:
  - seksion me **mur mbajtës në anën e majtë**,
  - seksion me **gërmim dhe mbushje**, sipas konfigurimit të terrenit
- Në fund të rrugës parashikohet ndërtimi i një **vendparkimi të përbashkët**, i realizuar përmes ndërtimit të një **muri pritës me lartësi 1.5 – 2.0 m**, si dhe mbushjes përkatëse

Ne kemi përgatitur tashmë një projekt-ide për rrugën dhe vendparkimin, për të cilin kemi dakordësuar edhe pronarët përkatës. Jemi të gatshëm që projektin e rrugës t'ia dhurojmë Bashkisë Konispol, duke mbuluar shpenzimet e hartimit të tij nga ana jonë, si dhe të ofrojmë në vijim edhe **projektin e detajuar teknik**, sipas kërkesave dhe standardeve të bashkisë.

Duke pasur parasysh edhe investimet që po realizohen dhe pritet të realizohen në territorin e bashkisë pas përmytjeve të fundit, kërkojmë që kjo rrugë të përfshihet në planifikimin dhe prioritetet e ndërtimit, si një ndërhyrje e nevojshme për zhvillimin rural dhe turistik të zonës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KONISPOL

**Relacion për pagesën e personave PAK për muajin Janar 2026**

*Të nderuar Këshilltare , I nderuar Z. Kryetar i këshillit , të nderuar pjesëmarrës!*

1-Për muajin **Janar 2026** janë trajtuar **117** persona të paaftë, nga këta **21** persona janë me kujdestar me një fond në totali **1,698,450 lekë**.

2-Persona të verbër janë trajtuar **31** persona, nga këta **10** persona janë me kujdestar me një fond **662,438 lekë**.

3-Persona Para-Tetraplegjik janë trajtuar **13** persona të cilët, nga këta **13** janë me kujdestar me një fond në total **612,573 lekë**.

4-Për kompesimin e energjisë elektrike kanë përfituar **11** persona të paaftë me fond **14,168 lekë**.

5-Për kompesimin e energjisë elektrike kanë përfituar **22** persona të verbër me fond **76,896 lekë**.

6-Për kompesimin e enrgjisë elektrike kanë përfituar **7** persona para/tetraplegjik me fond **21,000 lekë**.

**Në total fondi për muajin Janar 2026 është 3,085,525 lekë.**

ADMINISTRATORI SHOQEROR

Danijela Zejneli



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KONISPOL

ZYRA E NDIHMES EKONOMIKE  
PROJEKT-VENDIM

NR 1 DATË 22.01.2026

PËR DHËNIEN E PAGESËN E PERSONAVE P.A.K PËR PERIUDHEN 1-31 JANAR  
2026

Në mbështetje të nenit 29 , të Ligjit nr. 9355 datë 10.03.2005, ndryshuar me ligjin nr. 44/2016, date 01.09.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9355 ,date 10.03.2005”, të VKM-së nr. 787, date 14.12.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” të ndryshuar, dhe udhëzimeve në zbatim të tyre , Drejtoria e Ndihmës Ekonomike i propozon për miratim Këshillit të Bashkisë Konispol :

PËR BANORËT E NJËSISË ADMINISTRATIVE KONISPOL

I-Përfitojnë pagesë paaftësie për muajin Janar 2026 në total 43- persona me fond 587,448 lekë të ndarë në paaftësi , verbëri , para-tetraplegjik,

Konkretisht :

1-Persona të paaftë	<u>25</u> persona.
2-Kujdestari paaftësie	<u>6</u> persona
3- Verbëri	<u>7</u> persona
4-Kujdestari verbërie	<u>1</u> persona
5-Paraplegjik – tetraplegjik	<u>2</u> persona
6-Kujdestari para – tetraplegjik	<u>2</u> persona

ADMINISTRATORI

Danijela Zejneli

## I. PROCESI I VENDIMMARRJES

Këshilli Bashkiak, si organ vendimmarrës, politikbërës dhe mbikëqyrës, ka miratuar vendime që lidhen me funksionet kryesore të Bashkisë Konispol, të cilat ndërlidhen drejtpërdrejt me mirëqenien dhe mirëfunksionimin e komunitetit.

Nga ana tjetër, si organ politikbërës, Këshilli është përgjegjës për hartimin e politikave vendore. Gjatë vitit 2025, Këshilli ka vendosur për çështje të rëndësishme, si përcaktimi i nivelit të taksave dhe tarifave, si dhe miratimi i rregulloreve që kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e përditshme të qytetarëve dhe bizneseve të qytetit.

Gjatë vitit 2025, Këshilli Bashkiak Konispol ka zhvilluar një aktivitet të plotë, duke marrë vendime të rëndësishme dhe duke ruajtur komunikim të vazhdueshëm me komunitetin. Janë arritur objektiva të rëndësishëm në fusha sektoriale të vetëqeverisjes vendore, duke përfshirë shërbimet publike, sociale, ekonomike dhe të tjera.

Në fushën sociale, Këshilli Bashkiak ka shqyrtuar dhe miratuar një numër të madh vendimesh që synojnë mbështetjen e familjeve me probleme të thella sociale.

Këshilli ka miratuar çdo muaj vendime për ndihmë financiare për familjet në nevojë, jo vetëm nga fondet e kushtëzuara, por edhe nga të ardhurat e Bashkisë Konispol.

Nr.	Muaji	Ndihmë ekonomike për familje nga të ardhurat e Bashkisë	Ndihmë ekonomike për familje nga fondi i kushtëzuar 6 %
1.	Janar		6
2.	Shkurt		6
3.	Mars		5
4.	Prill		6
5.	Maj		6
6.	Qershor		6
7.	Korrik		6
8.	Gusht		6
9.	Shtator		5
10.	Tetor		6
11.	Nëntor		4
12.	Dhjetor		4

- Përmirësimin e demokracisë vendore dhe shërbimeve publike, përmes një bashkëpunimi më të mirë me administratat bashkiake dhe angazhimit të qytetarëve.

Këto aktivitete përbëjnë një hap të rëndësishëm drejt krijimit të këshillave më efikasë dhe më të suksesshëm në ofrimin e shërbimeve për komunitetet lokale.

Sic u përmend më sipër, mbetet një detyrë e rëndësishme për të ardhmen gjetja e mënyrave dhe formave të tjera për të komunikuar me publikun për çështje të rëndësishme, si: diskutimi për buxhetin e bashkisë, paketën fiskale, tjetërsimin dhe dhënien me qira të pronave, miratimin e standardeve dhe rregulloreve, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes aktive të komunitetit në vendimmarrje.

Gjithashtu, është e nevojshme që të rritet bashkëpunimi dhe angazhimi i ekzekutivit për të përgatitur në kohë raportet dhe informacionet e planifikuara për vitin 2026, si dhe për të përmbushur kërkesat e ardhshme të Këshillit Bashkiak.

Një tjetër detyrë e rëndësishme është që çdo këshilltar, për aktet normative që do të diskutohen dhe miratohen në këshill, të marrë paraprakisht opinione dhe vërejtje nga publiku në lagjen ose fshatin që përfaqëson, përpara se ato të shqyrtohen dhe të vendosen në këshill.

Duke ju uruar punë të mbarë për vitin 2026 dhe falënderuar secilin prej jush për kontributin e dhënë, ju nxisim të vazhdoni përpjekjet për të përmirësuar shërbimet dhe për të forcuar lidhjen me komunitetin!

## **SEKRETARE E KËSHILLIT BASHKIAK**

**Ilirjana ILJAZI**



**PËR BANORËT E NJËSISË ADMINISTRATIVE XARRË**

II-Përfitojnë pagesë paaftësie për muajin Janar 2026 në total 101-persona me fond lekë 1,446,931 lekë të ndarë në paaftësi , verbëri , para-tetraplegjik .

Konkretisht :

1-Persona të paaftë	<u>64</u> persona.
2-Kujdestari paaftësie	<u>8</u> persona
3-Persona të verbër	<u>12</u> persona
4-Kujdestari verbërie	<u>3</u> persona
5-Paraplegjik – tetraplegjik	<u>7</u> persona
6-Kujdestari para - tetraplegjik	<u>7</u> persona

**ADMINISTRATORI**  
**Denisa Sali**



**Kërkuesit:**

- Pajtim Çausi
- Krenar Çausi
- Ermal Çausi
- Ylli Hajta
- Izet Buqi
- Tanush Çausi
- Bajram Çausi
- Uran Çausi
- Vojsava Çausi

Duke ju falënderuar për vëmendjen dhe bashkëpunimin, mbetemi në pritje të një përgjigjeje dhe jemi të gatshëm për çdo sqarim apo takim të mëtejshëm.

Me respekt,  
**Kërkuesit**



**Tanush  
caushi**

Digitally signed by  
Tanush caushi  
Date: 2025.12.26  
01:34:57 +0200

**RELACION**  
**MBI MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË GRANTIT TË PERFORMANCËS 2025**

Përschëndetje të gjithëve!

Duke ju uruar një vit sa më të mbarë, si në punë ashtu edhe në familje.

Sjellim para jush këtë projekt vendim të parë për përdorimin e "Grantit i Performancës për bashkitë 2025".

Në zbatim të ligjit nr. 115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025", Aneksit nr. 9 "Granti i Performancës për Bashkitë", si dhe Udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor nr. 1031/5, datë 11.07.2025 dhe nr. 10725, datë 11.07.2025, Bashkisë i është akorduar Fondi i Grantit të Bazuar në Performancë për vitin 2025. Ky fond sigurohet nga buxheti i shtetit, si dhe nga burime të financimit të huaj, dhe ka për qëllim mbështetjen e njësisve të vetëqeverisjes vendore në realizimin e investimeve që përmirësojnë shërbimet publike dhe infrastrukturën vendore, në përputhje të plotë me përcaktimet e ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, dhe ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore".

Bazuar në nevojat konkrete të territorit dhe në prioritetet e zhvillimit lokal, propozohet që fondi i përfutur nga "Grantit i Performancës 2025" në vlerën 11,054,833 (njëmbëdhjetë milionë e pesëdhjetë e katër mijë e tetëqind e tridhjetë e tre) të përdoret për realizimin e investimit "Rikonstruksioni i rrugës së brendshme Qendër – Lagjja Barç dhe sistemimi i ujërave të shiut në degëzimin e rrugës së shkollës 9-vjeçare në fshatin Shalës".

Për sa më sipër, në përputhje me kuadrin ligjor dhe kompetencat e Këshillit të Bashkisë, i propozohet Këshillit të Bashkisë miratimi i përdorimit të Grantit të Performancës 2025 për realizimin e këtij investimi.

Bashkëngjitur këtij projekt-vendimi do të gjeni preventivin e punimeve për këtë investim si dhe tabelën e akordimit të fondeve.

Duke ju falënderuar

**DREJTOR FINANCE**

Ornela EMINI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KOMUNALE  
DREJTORIA EKONOMIKE

PROJEKT-VENDIM

NR 1, DATË 23.01.2026

**MBI MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË GRANDIT TË PERFORMANCËS 2025**

Në zbatim të ligjit nr. 115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025", aneksit 9 "Granti i Performancës për bashkitë", si dhe udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Shtetit për Pushtetin Vendor nr. 1031/5, datë 11.07.2025, dhe nr. 10725, datë 11.07.2025 është akorduar Fondi i Grantit të Bazuar në Performancë për vitin 2025 sipas bashkive, me burim financimi buxhetin e shtetit si dhe me burim financimin e huaj, në përputhje të plotë me përcaktimet e ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, dhe ligjit nr. 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore" i propozojme Këshillit të Bashkisë:

1. Të miratojë përdorimin e "Grandit të performancës 2025", për Rikonstruksionin e rrugës së brendshme Qendër- Lagjja Bare dhe sistemimi i ujërave të shiut në degëzimin e rrugës së shkollës 9-vjecare në fshatin Shalës.

Kapitulli	Programi	Nr. Artikullit	Vlera	Emërtimi
01	4520	231	4,032,296	Rikonstruksionin e rrugës së brendshme Qendër- Lagjja Bare dhe sistemimi i ujërave të shiut në degëzimin e rrugës së shkollës 9-vjecare në fshatin Shalës
02	4520	231	7,022,537	

KRYETARI I BASHKISË

Ergest DULE



Projektoesi: Tanush Çauhi

Objekti: RRuga "Kryqezimi i Sheqir Korca" - Familjet Caushi, Konispol

Data: 05-01-2026

## PREVENTIV

NR	KODI	EMËRTIMI I PUNIMEVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI	VLEFTA
<b>1. PUNIME GERMIMI</b>						
1	3.67/a	Germim themel vecuar (gropa) sip 10-30 m <sup>3</sup> , shkerab i bote, me h= 1.5 m, me makineri, e zakonshme	m3	566.0	3,450.18	1,952,804.13
<b>Shuma 1:</b>						<b>1,952,804.13</b>
<b>2. PUNIME SHITRESASH</b>						
2	3.164/1a	Mbushje me material te germuar ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri	m3	70.0	712.10	49,846.72
3	3.212/c	Shtrese stabilizant t=15cm	m2	70.0	653.41	45,738.91
<b>Shuma 2:</b>						<b>95,585.63</b>
<b>3. PUNIME SHITRESASH 2</b>						
4	2.258	Nenshtrese zhavori	m3	140.0	3,594.60	503,243.60
5	2.262/5	Shtrese betoni C20/25	m3	70.0	14,600.01	1,022,000.38
<b>Shuma 3:</b>						<b>1,525,243.98</b>
<b>4. PRODHIMI I MATERIALEVE TE NDERTIMIT</b>						
6	1.29/p	Beton C-16/20 (Me zall)	m3	16.0	8,210.03	131,360.55
7	1.85/p	Pergatitje hekur betoni i zakonshem Ø 6 - 10 mm2	kg	1280.0	158.14	202,424.31
<b>Shuma 4:</b>						<b>333,784.86</b>
<b>Shuma Analiza</b>						<b>3,907,418.50</b>
<b>Fondi Rezervë (5.0%)</b>						<b>195,370.94</b>
<b>Shuma Analiza + Fondi Rezervë (5.0%)</b>						<b>4,102,789.44</b>
<b>TVSH (20%)</b>						<b>820,557.90</b>
<b>Shuma me TVSH</b>						<b>4,923,347.34</b>
<b>Totali</b>						<b>4,923,347.50</b>

**Preventivuesi:**

Tanush Caushi

**Tanush  
caushi**

Digitally signed by Tanush  
caushi  
Date: 2024.01.05 21:53:58  
+0200



**Shënime:**

Ky preventiv eshte bazuar tek projekti teknik

**Gjatë periudhës janar-dhjetor 2025, Këshilli Bashkiak Konispol ka marrë gjithsej 56- vendime.**

Vlen të theksohet se të gjitha vendimet e Këshillit Bashkiak Konispol janë miratuar në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi. Institucioni i Prefektit të Qarkut Vlorë ka vlerësuar pozitivisht ligjshmërinë e të gjitha vendimeve të marra nga Këshilli Bashkiak Konispol për këtë periudhë 12 mujore.

Gjithashtu, nga ana e Prefektit të Qarkut Vlorë është kryer kontroll i rregullt, dhe në raportin e tij të fundit, është konstatuar se Këshilli Bashkiak Konispol ka zbatuar me korrektësi të gjitha detyrimet ligjore.

Nga sa përmendëm më lart, këto vendimmarrje dëshmojnë qartë bashkëpunimin efektiv të Këshillit me administratën e Bashkisë Konispol për të trajtuar në kohë dhe në përputhje me legjislacionin shqetësimet dhe problematikat e qytetarëve.

Gjatë kësaj periudhe, Këshilli Bashkiak ka mbajtur rregullisht mbledhjet e radhës, sipas tabelës së mëposhtme:

<b>Muaji</b>	<b>Nr i mbledhjeve</b>	<b>Data e mbledhjes</b>
Janar	1	30.01.2025
Shkurt	1	27.02.2025
Mars	1	27.03.2025
Prill	1	30.04.2025
Maj	1	29.05.2025
Qershor	1	17.06.2025      30.06.2025
Korrik	1	31.07.2025
Gusht	1	28.08.2025
Shtator	1	30.09.2025
Tetor	1	30.10.2025
Nëntor	1	27.11.2025
Dhjetor	1	29.10.2025
<b>Total</b>	<b>13</b>	

Mbetet detyrë e rëndësishme zbatimi praktik i vendimeve dhe për të arritur këtë në mënyrë sa më efektive, kërkohet bashkëpunimi i të gjitha hallkave të përfshira (përfaqësues, ekzekutiv, komunitet).



REPUBLIKA E SHqipërisë  
KRYEMINISTRIA  
MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR  
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEJEN E VETËQEVERISJES VENDORE

Vendimi për fuqimtar (KVA)-së ndri shpërndarjen e shumave sipas bashkiqe dhe burimi i financimit të Grantit Bazuar në Performancë 2025

Bashkia		GBP 2025			Burimi		
		Pesha në %	Shuma Fikse	Shuma Shtesë	Total	I brendshëm	I huaj
<b>Nr.</b>	<b>Total</b>	<b>0.36</b>	<b>163,124,683.82</b>	<b>284,093,550.48</b>	<b>447,218,234.30</b>	<b>200,000,000.00</b>	<b>247,218,234.30</b>
1	Belsh	0.24	1,759,547.15	3,064,379.87	4,823,927.02	2,157,303.37	2,666,623.65
2	Berat	0.30	2,199,433.94	3,830,474.84	6,029,908.78	2,696,629.21	3,333,279.56
3	Bulqizë	0.45	3,299,150.91	5,745,712.26	9,044,863.17	4,044,943.82	4,999,919.35
4	Cërrik	0.49	3,592,408.77	6,256,442.24	9,848,851.00	4,404,494.38	5,444,356.62
5	Delvinë	0.44	3,225,836.44	5,618,029.76	8,843,866.21	3,955,056.18	4,888,810.03
6	Devoll	0.15	1,099,716.97	1,915,237.42	3,014,954.39	1,348,314.61	1,666,639.78
7	Dibër	0.55	4,032,295.56	7,022,537.20	11,054,832.76	4,943,820.22	6,111,012.53
8	Dimal	0.39	2,859,264.12	4,979,617.29	7,838,881.41	3,505,617.98	4,333,263.43
9	Dryakë	0.39	2,859,264.12	4,979,617.29	7,838,881.41	3,505,617.98	4,333,263.43
10	Dropull	0.59	4,325,553.41	7,533,267.18	11,858,820.59	5,303,370.79	6,555,449.81
11	Durrës	0.25	1,832,861.62	3,192,062.36	5,024,923.98	2,247,191.01	2,777,732.97
12	Elbasan	0.70	5,132,012.52	8,937,774.62	14,069,787.15	6,292,134.83	7,777,652.32
13	Fier	0.14	1,026,402.50	1,787,554.92	2,813,957.43	1,258,426.97	1,555,530.46
14	Finiq	0.15	1,099,716.97	1,915,237.42	3,014,954.39	1,348,314.61	1,666,639.78
15	Fushë-Arrëz	0.59	4,325,553.41	7,533,267.18	11,858,820.59	5,303,370.79	6,555,449.81
16	Gjirokastrë	0.05	366,572.32	638,412.47	1,004,984.80	449,438.20	555,546.59
17	Gramsh	0.55	4,032,295.56	7,022,537.20	11,054,832.76	4,943,820.22	6,111,012.53
18	Has	0.54	3,958,981.09	6,894,854.71	10,853,835.80	4,853,932.58	5,999,903.21
19	Himarë	0.55	4,032,295.56	7,022,537.20	11,054,832.76	4,943,820.22	6,111,012.53
20	Kamëz	0.50	3,665,723.23	6,384,124.73	10,049,847.96	4,494,382.02	5,555,465.94
21	Kavujë	0.05	366,572.32	638,412.47	1,004,984.80	449,438.20	555,546.59
22	Këlcyrë	0.14	1,026,402.50	1,787,554.92	2,813,957.43	1,258,426.97	1,555,530.46
23	Klos	0.35	2,566,006.26	4,468,887.31	7,034,893.57	3,146,067.42	3,888,826.16
24	Kolonjë	0.79	5,791,842.71	10,086,917.07	15,878,759.78	7,101,123.60	8,777,636.18
25	Konispol	0.55	4,032,295.56	7,022,537.20	11,054,832.76	4,943,820.22	6,111,012.53
26	Korçë	0.10	733,144.65	1,276,824.95	2,009,969.59	898,876.40	1,111,093.19
27	Krujë	0.05	366,572.32	638,412.47	1,004,984.80	449,438.20	555,546.59
28	Kuçovë	0.14	1,026,402.50	1,787,554.92	2,813,957.43	1,258,426.97	1,555,530.46
29	Kukës	0.39	2,859,264.12	4,979,617.29	7,838,881.41	3,505,617.98	4,333,263.43



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KONISPOL  
ZYRA E BURIMEVE NJERËZORE

PROJEKT-VENDIM

Nr. 01 ,Datë 23.01, 2026

PËR MIRATIMIN E NUMRIT MAKSIMAL TË PUNONJËSVE TË BASHKISË  
KONISPOL PËR VITIN 2026

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Ligjit nr .7961 , datë 12.07.1995 "Kodi i punes në Republikën e Shqiperisë" ,Ligjit 152/2013 "Për Nëpunësin Civil" ,Kryetari i Bashkisë dhe Zyra e Burimeve Njerezore , i propozojmë Këshillit të Bashkisë:

1. Të miratojë numrin maksimal të punonjësve të Bashkisë Konispol për vitin 2026 ,prej 161 punonjësish si më poshtë:

- Kabineti 8 punonjës
- Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik 13 punonjës
- Drejtoria e Planifikimit dhe Monitorimit të Territorit 30 punonjës
- Drejtoria e Shërbimeve Komunitare 61 punonjës
- Drejtoria e Bujqësisë, Blegtorisë dhe Pyje-Kullotave 21 punonjës
- Drejtoria e Administrimit të Përgjithshëm dhe Integritimit European 16 punonjës
- Drejtoria e Arsimit Parashkollor 12 punonjës

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe zyra e Burimeve Njerezore për zbatimin e këtij projekt-vendimi.

Përgj. SEKTORIT B.NJ.

Emiljano Hazbi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KONISPOL  
KËSHILLI

**PROJEKTET PRIORITARE PER VITIN 2026**

NR	EMRTIMI	VLERA ME TVSH
1	RIPARIM DHE MBROJTJE E KANALIT TË JANJARIT	65,300,440
2	REHABILITIM I RRUGES HYRESE TE KONISPOLIT (LOTI II)	75,000,000
3	MASA INXHINIERIKE PËR MBROJTJEN NGA RRËSHQITJA PRANË LIQENIT NË FSHATIN MURSI	67,672,214
4	NDERTIM I UNAZES SE BUARIT, KONISPOL	106,286,570
5	REHABILITIM I KANALIT (KOTEC-BAUDH) NË FUSHËN E SHALËSIT	37,605,495
6	RIKONSTRUKSION I RRUGËS "KAMARE-SHKOLLA", CIFLIK	20,007,735
7	REHABILITIM I RRUGËS XARRË - KALIVUA	63,485,325
8	SISTEMIM I K.U.Z NË CIFLIK DHE KONISPOL	8,000,000
9	SISTEMIM ASFALTIM I RRUGËS HYRËSE NGA KRAHU I DIGËS MURSI	15,738,629
10	BLERJE BETONI DHE ASFALTOBETONI	20,000,000
11	REHABILITIM I RRUGËS SHALËS-DISHAT VËRVË	56,000,000
12	RIKONSTRUKSION I GODINES SE ZJARRFIKESES	16,968,753
13	NDËRTIM I RRJETIT TE KUZ ,FSHATI MURSI	160,928,100
14	NDËRTIM I TREGUT BUJQËSOR, MURSI	99,990,539
15	NDERTIM PARKU REKREATIV NE KONISPOL	14,500,000
16	RIKONSTRUKSION DHE MIREMBAJTJE E RRUGEVE BUJQESORE	15,000,000
17	BLERJE AUTOMJETI ZJARRFIKËS	9,000,000

Kryetari i Këshillit  
Arianit Taka



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KONISPOL

KËSHILLI

RAPORT

**PËR PUNËN VJETORE TË KËSHILLIT BASHKIAK KONISPOL PËR  
VITIN 2025**

Të nderuar këshilltarë !

Këshilli Bashkiak, si organ përfaqësues dhe vendimmarrës i qeverisjes bashkiake, ushtron përgjegjësitë e tij qeverisëse duke respektuar parimet e demokracisë vendore, transparencës qeverisëse dhe ligjshmërisë. Ai siguron përdorimin ekonomik, efikas dhe efektiv të burimeve njerëzore, financiare, fizike, natyrore dhe teknologjike të Bashkisë.

Veprimtaria e Këshillit Bashkiak Konispol mbështetet në zbatimin e detyrimeve që burojnë nga ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi, si dhe nga rregulloret e miratuara nga vetë Këshilli, të cilat janë si më poshtë:

1. Ligji nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
2. Ligji nr.8548,datë 11.11.1999“Për Ratifikimin e Kartës Europiane të AutonomisëVendore“
3. Ligji nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
4. Ligji nr. 139, datë 17.12.2015 “Për Vetë-Qeverisjen Vendore”
5. Ligji nr. 44, datë 30.4.2015 “Kodi i Proçedurave Administrative”
6. Ligji nr.8480,datë 27.5.1999,“Për Funkionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”
7. Ligji nr.107, datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”
8. Ligji nr.119, datë 18.09.2014 “Për të Drejtën e Informimit”
9. Ligji nr. 146, datë 30.10.2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”
10. Ligji nr.68, datë 27.04. 2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”
11. Ligji nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”
12. Ligji nr.9970, datë 24.70.2008 “Për Barazinë Gjinore në Shoqëri”
13. Ligji nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”
14. Ligji nr.9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”
15. Ligji nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave”,i ndryshuar
16. Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”
17. . Ligji nr.45/2019, “Për Mbrojtjen Civile”,i ndryshuar
18. Vendim I Këshillit Bashkiak “Për miratimin e rregullores për funksionimin e Këshillit të Bashkisë Konispol nr.30, datë 03.06.2020

<b>4. TE NDRYSHME, ELEKTRIKE DHE SINJALISTIKA</b>						
<b>4</b>	3.164/St	F.V. Tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=800 mm	ml	75	23,573.37	1,768,002.75
<b>SHUMA 4:</b>						<b>1,768,002.75</b>
<b>5. PUNIME BETONI E BETONARMEJE</b>						
<b>5</b>	3.244/1	Struktura te holla monolite betoni C 20/25(kaptazh ,jastek betoni)	m3	4	16,815.77	67,263.08
<b>SHUMA 5:</b>						<b>67,263.08</b>
<b>6. NENSHTRESA DHE SHTRESA NE TERRITORIN E NDERTESAVE</b>						
<b>6</b>	2.595	F.V. zgate gize 40x60 cm	copë	8	10,584.00	84,672.00
<b>SHUMA 6:</b>						<b>84,672.00</b>
<b>SHUMA B = 1+2+3+4+5+6</b>						<b>2,085,589.20</b>
<b>SHUMA A + B</b>						<b>9,212,342.21</b>
<b>Shuma TVSH (20%)</b>						<b>1842468.44</b>
<b>Shuma me TVSH</b>						<b>11,054,810.65</b>

**Preventivuesi**  
**Ing.Lefter Ballabani**

**Investitori: Bashkia Konispol**

Arbin	0.29	2,126,119.47	3,702,792.34	5,828,911.82	2,606,741.57	3,222,170.24
Arzbë	0.29	2,126,119.47	3,702,792.34	5,828,911.82	2,606,741.57	3,222,170.24
Barshovë	0.14	1,026,402.50	1,787,554.92	2,813,957.43	1,258,426.97	1,555,530.46
Brazhd	0.80	5,865,157.17	10,214,599.57	16,079,756.74	7,191,011.24	8,888,745.50
Bushnjë	0.34	2,492,691.80	4,341,204.82	6,833,896.61	3,056,179.78	3,777,716.84
Dibër e Madhe	0.55	4,032,295.56	7,022,537.20	11,054,832.76	4,943,820.22	6,111,012.53
Durrës	0.50	3,665,723.23	6,384,124.73	10,049,847.96	4,494,382.02	5,555,465.94
Fier	0.14	1,026,402.50	1,787,554.92	2,813,957.43	1,258,426.97	1,555,530.46
Gjakovë	0.80	5,865,157.17	10,214,599.57	16,079,756.74	7,191,011.24	8,888,745.50
Gjermaniaj	0.14	1,026,402.50	1,787,554.92	2,813,957.43	1,258,426.97	1,555,530.46
Gjirë	0.15	1,099,716.97	1,915,237.42	3,014,954.39	1,348,314.61	1,666,639.78
Gjovane	0.44	3,225,836.44	5,618,029.76	8,843,866.21	3,955,056.18	4,888,810.03
Gjokaj	0.39	2,859,264.12	4,979,617.29	7,838,881.41	3,505,617.98	4,333,263.43
Gjokë	0.34	2,492,691.80	4,341,204.82	6,833,896.61	3,056,179.78	3,777,716.84
Gjogajec	0.49	3,592,408.77	6,256,442.24	9,848,851.00	4,404,494.38	5,444,356.62
Gjoni	0.34	2,492,691.80	4,341,204.82	6,833,896.61	3,056,179.78	3,777,716.84
Gjovane	0.70	5,132,012.52	8,937,774.62	14,069,787.15	6,292,134.83	7,777,652.32
Gjokë	0.69	5,058,698.06	8,810,092.13	13,868,790.19	6,202,247.19	7,666,543.00
Gjokë	0.29	2,126,119.47	3,702,792.34	5,828,911.82	2,606,741.57	3,222,170.24
Gjokë	0.29	2,126,119.47	3,702,792.34	5,828,911.82	2,606,741.57	3,222,170.24
Gjokë	0.15	1,099,716.97	1,915,237.42	3,014,954.39	1,348,314.61	1,666,639.78
Gjokë	0.35	2,566,006.26	4,468,887.31	7,034,893.57	3,146,067.42	3,888,826.16
Gjokë	0.25	1,832,861.62	3,192,062.36	5,024,923.98	2,247,191.01	2,777,732.97
Gjokë	0.55	4,032,295.56	7,022,537.20	11,054,832.76	4,943,820.22	6,111,012.53
Gjokë	0.14	1,026,402.50	1,787,554.92	2,813,957.43	1,258,426.97	1,555,530.46
Gjokë	0.14	1,026,402.50	1,787,554.92	2,813,957.43	1,258,426.97	1,555,530.46
Gjokë	0.60	4,398,867.88	7,660,949.68	12,059,817.55	5,393,258.43	6,666,559.13
Gjokë	0.05	366,572.32	638,412.47	1,004,984.80	449,438.20	555,546.59
Gjokë	0.55	4,032,295.56	7,022,537.20	11,054,832.76	4,943,820.22	6,111,012.53
Gjokë	0.39	2,859,264.12	4,979,617.29	7,838,881.41	3,505,617.98	4,333,263.43
Gjokë	0.05	366,572.32	638,412.47	1,004,984.80	449,438.20	555,546.59
Gjokë	0.35	2,566,006.26	4,468,887.31	7,034,893.57	3,146,067.42	3,888,826.16

### Kryetar Komisioni

Emër, Mbiemër, Firmë

Date: 20.01.2026.

PROJEKTUESI BASHKIA KONISPOL

OBJEKTI RIKONSTRUKSION I RRUGES SE BRENDESHME QENDER -- LAGJIA BARC DHE SISTEMIMI I UJRAVE TE SHIUT NE DEGEZIMIN E RRUGES SE SHKOLLES 9- VJECARE NE FSHATIN SHALES

**PREVENTIV PUNIMESH**

NR.	KODI	EMËRTIMI I PUNIMEVE.	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI	VLEFTA
<b>A PUNIME NE RRUGE</b>						
<b>1. PUNIME GERMIMI</b>						
1	3.17/a	Germime dheu ne seksion te lire me krahe,ne toke te bute,kateg.I-II.	m3	11	2,854.78	31,402.58
<b>SHUMA 1:</b>						<b>31,402.58</b>
<b>2. PUNIME SHITRESASH</b>						
2	3.212/b	Shtrese stabilizant t=10cm	m2	870	475.31	413,519.70
3	3.969/1	Sperkatje me emulsion bituminoz 1 l/m2	m2	2985	231.07	689,743.95
<b>SHUMA 2:</b>						<b>1,103,263.65</b>
<b>3. ANALIZA TEKNIKE</b>						
4	3.222/2	Shtrese binderi me granil gur kave,6cm,me makineri	m2	870	1,707.96	1,485,925.20
5	3.226/1	Shtrese astaltobetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri	m2	870	1,204.02	1,047,497.40
6	3.226/2	Shtrese astaltobetoni me granil guri kave, 5cm, me makineri	m2	2115	1,477.58	3,125,081.70
<b>SHUMA 3:</b>						<b>5,658,504.30</b>
<b>4. PUNIME BETONI E BETONARMEJE</b>						
7	3.243/1	Struktura te holla monolite betoni C 16/20(kunete)	m3	21	15,884.88	333,582.48
<b>SHUMA 4:</b>						<b>333,582.48</b>
<b>SHUMA A = 1+2+3+4</b>						<b>7,126,753.0</b>
<b>B PUNIME NE SISTEMIMIN I UJRAVE TE SHIUT</b>						
<b>1. NDERTIMI I VEPRAVE TE ARTIT+KANALIZIME</b>						
1	3.405/1	Prishje struktura prej betoni	m3	1.4	2,932.45	4,105.43
<b>SHUMA 1:</b>						<b>4,105.43</b>
<b>2. PUNIME DHEU</b>						
2	2.15	Germim e mbushje dheu me krah per kanale kategori III, h=1.5m	m3	80	1,749.70	139,976.00
<b>SHUMA 2:</b>						<b>139,976.00</b>
<b>3. PUNIME SHITRESASH</b>						
3	3.182/a	Shtrese rere natyrore t=10cm	m2	63	342.38	21,569.94
<b>SHUMA 3:</b>						<b>21,569.94</b>

**PËR BANORËT E NJËSISË ADMINISTRATIVE MARKAT**

**KTË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE NGA FONDI PREJ 6 %:**

**A-PËR MUAJIN DHJETOR 2025 :**

Përfitojnë ndihmë ekonomike për muajin Dhjetor 2025, 3 familje, me fond 12,729 lekë e ndarë :

me ndihmë të plotë 3 familje me fond 12,729 lekë, me ndihmë të

pjesëshme 0, familje 0 lekë, për fëmijët në shkollë përfitojnë 0 fëmijë me fond 0lekë,  
për vaksinat e kryera përfitojnë 0 fëmijë me fond 0lekë.

Kompesim energjie 1 familje me fond 0 leke.

Perkatesishi familjet si me poshte:

Xhevahire Lame	-	në masën 3.146 lekë
Pashe Arapi	-	në masën 5,227 lekë
Flogert Avdi	-	në masën 4,356 lekë

**ADMINISTRATORI**

**Jaho Hyso**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KONISPOL  
ZYRA E BURIMEVE NJERËZORE

RELACION SHPJEGUES

**Mbi projekt vendimin për miratimin e numrit maksimal të punonjësve të Bashkisë Konispol për vitin 2026**

*Të nderuar këshilltarë !*

Bazuar në Ligjin nr.139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", miratimi i numrit maksimal të punonjësve të bashkisë është e drejta e Këshillit të Bashkisë.

Nga ana e administratës së Bashkisë Konispol, duke u mbështetur në nevojat e institucionit dhe në legjislacionin dhe udhëzimet në fuqi, është punuar dhe hartuar ky projekt-vendim për strukturën organizative të Bashkisë Konispol që do të funksionojë deri në mbyllje të vitit kalendarik 2026.

Në krahasim me strukturën e vitit të kaluar kemi ndryshime si më poshtë:

Kemi shtuar 1 pozicion tek drejtoria e arsimit parashkollor Edukatore

Kemi shtuar 1 pozicion tek sektori i policisë bashkiake si Punonjës i Policisë Bashkiake

Kemi krijuar dhe 1 sektor i cili është në varësi të Dr. të Bujqësisë i cili do të menaxhojë situatën e vaditjes së tokave bujqësore , kanalet vaditëse dhe ato kulluese.

Miratimi i këtij projekt-vendimi nga ana juaj do të sigurojë vazhdimësinë normale të administratës së institucionit si dhe të shërbimeve ndaj qytetarëve.

Duke ju falënderuar për mbështetjen tuaj, ju ftoj ta votoni propozimin për miratimin e numrit maksimal të punonjësve të Bashkisë Konispol për vitin 2026.

Duke ju falënderuar !

**Përgj.SEKTORIT B.N.J.**

**Emiljano Hazbi**

**PËR BANORËT E NJËSISË ADMINISTRATIVE XARRË**

**ITË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE NGA FONDI PREJ 6 %**

**A- PËR MUAJIN DHJETOR 2025 :**

Përfitojnë ndihmë ekonomike për muajin **Dhjetor 2025**, 2 familje, me fond **5,881 lekë** e ndarë :

me ndihmë të plotë 0 familje me fond 0 lekë, me ndihmë të

pjesëshme 0, familje 0 lekë, për fëmijët në shkollë përfitojnë 0 fëmijë me fond 0lekë,  
për vaksinat e kryera përfitojnë 0 fëmijë me fond 0 lekë.

Kompesim energjie 0 familje me fond 0 leke.

**Emiljano Xhaferi - në masën 2,178 lekë**

**Ali Pana - në masën 3,703 lekë**

**ADMINISTRATORI  
Denisa Sali**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KONISPOL  
DREJTORIA E SHËRBIMEVE

RELACION PËR  
PROJEKT-VENDIM  
Nr 1 Date 22.01.2026

“PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PROJEKTEVE PRIORITARE PËR VITIN 2026”

Të ndëruar këshilltarë!

Në zbatim të Ligjit Nr. 139/2015 për Vetqeverisjen Vendore, kërkohet miratimi i listës së projekteve prioritare dhe vlerave respektive për vitin 2024.

Kjo listë është hartuar mbi bazën e nevojave dhe takimeve me publikun me qëllim zhvillimin ekonomik dhe ardhjen në ndihmë të komunitetit.

Duke ju falenderuar !

DPZHMT

Artur BEQIRI





REPUBLIKA E SHqipërisë  
BASHKIA KONISPOL

**Relacion për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi 6 % për muajin Dhjetor 2025**

Të nderuar Keshilltarë, I nderuar z.Kryetar i Këshillit, të nderuar pjesëmarrës:

-Për muajin Dhjetor 2025 është dhënë ndihmë ekonomike për 56 familje me një fond **309,405 lekë**, si dhe 1 person me statusin e Jetimit në masën **10200 lekë**.

Në total fondi i muajit Dhjetor 2025 për Bashkinë Konispol shkon në masën **319,605 lekë**.

Fondi prej 6 % llogaritet mbi këtë vlerë shkon në masën **18,564 lekë**, nga i cili do të trajtohen familjet e përjashtuara nga sistemi për arsye se ; - Nuk kanë marrë pikët e mjaftueshme.

-Nga ky fond për muajin Dhjetor 2025 do të trajtohen 5 Familje, në masën **18,610 lekë**.

Në total fondi 6 % për muajin Dhjetor 2025 është **18,610 lekë**.

Ndërsa fondi i përdorur nga Bashkia për muajin Dhjetor 2025 është **18,564 lekë**.

ADMINISTRATORI SHOQEROR  
Danijela Zejneli



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KONISPOL

ZYRA E NDIHMES EKONOMIKE  
PROJEKT-VENDIM

NR 2 DATË 22/01/2026

**PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI 6 % PËR PERIUDHËN 1 – 31  
DHJETOR 2025.**

Në mbështetje të nenit 27/1 të Ligjit nr. 9355 datë 10.03.2005, "Për ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore" i ndryshuar me ligjin nr. 44/2016, datë 21.04.2016, në pikën 7 të Kreut II të Vendimit 955 datë 07.12.2016 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike", ndryshuar me Vendimin nr.592 datë 18.10.2017 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9355, datë 07.12.2016, "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike" dhe udhëzimeve në zbatim të tyre, Drejtoria e Ndihmës Ekonomike i propozon për miratim Këshillit të Bashkisë Konispol:

**PËR BANORËT E NJËSISË ADMINISTRATIVE KONISPOL**

**ITË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE NGA FONDI PREJ 6 %:**

**A-PËR MUAJIN DHJETOR 2025 :**

Përfitojnë ndihmë ekonomike për muajin Dhjetor 2025, 0 familje, me fond 0 lekë e ndarë :

me ndihmë të plotë 0 familje me fond 0 lekë, me ndihmë të

pjesëshme 0, familje 0 lekë, për fëmijët në shkollë përfitojnë 0 fëmijë me fond 0lekë,  
për vaksinat e kryera përfitojnë 0 fëmijë me fond 0lekë.

Kompesim energjie 0 familje me fond 0 leke.

Perkatesisht familjet si me poshte:

**ADMINISTRATORI**  
**Danijela Zejneli**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KONISPOL  
DPZHKT

**PROJEKT-VENDIM**

**Nr 1 Date 22.01.2026.**

**“PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PROJEKTEVE PRIORITARE PËR VITIN 2026”**

Bazuar në Ligjin Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit, Zhvillimit dhe Monitorimit të Territorit i propozojnë Këshillit të Bashkisë:

1. Të miratojë listën bashkëlidhur të projekteve prioritare të investimeve për vitin 2026.

Për DPZHKT

Artur BEQIRI



KRYETAR I BASHKISË



ERGËST DULE



PËR BANORËT E NJËSISË ADMINISTRATIVE MARKAT

III-Përfitojnë pagesë paaftësie për muajin Janar 2026 në total 61 persona me fond 939,082 lekë të ndarë në paaftësi , verbëri , para-tetraplegjik.

Konkretisht :

1-Persona të paaftë	<u>28</u> persona.
2-Kujdestari paaftësie	<u>7</u> persona
3-Persona të verbër	<u>12</u> persona
4-Kujdestari verbërie	<u>6</u> persona
5-Paraplegjik – tetraplegjik	<u>4</u> persona
6-Kujdestari para – tetraplegjik	<u>4</u> persona

**ADMINISTRATORI**  
**Jaho Hyso**

